



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 248/25 Dt. 15.04.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit, DVV International dhe OJQ THY 01 Nr.199/25, të datës 24.03.2025 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim të projektit

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit që ka për qëllim konsolidimin e përpjekjeve për krijimin e mundësive për të rinjtë dhe të rriturit përmes ofertave holistike të arsimit joformal dhe informal. Ky bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3 të Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit, DVV International dhe OJQ THY 01 Nr.199/25, të datës 24.03.2025 (aneksi 1 i këtij Memorandumi), kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 10.000,00 € (dhjetëmijë euro).
2. Zyrtare Monitoruese e projektit nga Komuna e Prizrenit, caktohet Laura Kelmendi Selaj.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit, DVV International dhe OJQ THY 01 Nr.199/25, të datës 24.03.2025.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe zyrtarja monitoruese për zbatimin e vendimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Zyrtares monitoruese,
 - DVV International,
 - OJQ THY,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

